



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:173513

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05751713

Ac.nr.4015/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F. H. dhe G.H. të dy nga fshati K., Komuna e G. të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre J. I. avokat nga P., rruga XXXX, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., të cilin e përfaqëson e autorizuar e saj A. Gj., lidhur me kompenzimin e dëmit, vlera e kontestit 19,948.00 euro, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.107/2018, të datës 21.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **20.05.2024** nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR ankesa e paditëses së parë F. H. nga fshati K./Komuna e G., ushtruar përmes të autorizuarit të saj, avokat A. I. nga P., ashtu që: **NDRYSHOHET PJESËRISHT** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.107/2018, i datës 21.04.2021, sa i përket pikës **I** të dispozitivit, lidhur me kompenzimin e dëmit jo material sa i përket dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar për paditësen e parë F. H., ashtu që, lidhur me këtë pikë, **gjykohet** si në vijim:

II.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., që në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike dhe frikës së pësuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 10.03.2018 në aksin rrugor “C.-K., paditëses së parë F. H. nga fshati K./Komuna e G., t’ia paguajë shumën totale prej 7000 euro, si në vijim:

-në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara shumën totale prej **4,000 euro**,

-në emër të frikës së pësuar shumën totale prej **3,000 euro**, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 21.04.2021, e gjer në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.

III.Pjesa tjetër e ankesës së paditësve F. H. dhe G. H. të dy nga fshati K./Komuna e G., ushtruar përmes të autorizuarit të tyre, avokat A. I. nga P., sa i përket **I** dhe **II** të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.107/2018, i datës 21.04.2021,**REFUZOHET SI E PA BAZUAR**, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.107/2018, i datës 21.04.2021, në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

IV.**REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.107/2018, i datës 21.04.2021, sa i përket pikës **I** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm me Aktgjykimin C.Nr.107/2018 të datës 24.04.2021 ka vendosur sin ë vijim:

I.**APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësve F. H.dhe G. H. të dy nga fshati K., Komuna e G., **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “S” me seli në P., që paditësve F. H. dhe G. H. për lëndimet trupore të pësura në fatkeqësinë e komunikacionit me datën 10.03.2018, t’ia paguaj dhe atë:

1. Paditëses F. H.

Dëmin jo material:

- Për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 2,700.00 euro
- Për frikën e përjetuar shumën prej..... 1,900.00 euro
- Për shëmtim trupor shumën prej 1,200.00 euro
- Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 6 % shumën prej.....2,000.00 euro

Dëmin material:

- Për ndihmën dhe kujdesin nga personi tjetër shumën prej 30 euro
- Për ushqimin e përforcuar shumën prej294 euro
- Për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej ..1,480.30 euro apo gjithsejtë shumën prej 9,604.30 euro, si dhe

2. Paditësit G.H.

Dëmin jomaterial:

- Për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1, 300 euro;
- Për frikën e përjetuar 1,000 euro

Dëmin dëmi material:

-Për ndihmën dhe kujdesin nga personi tjetër shumën prej30 euro
-Për ushqimin e përforcuar shumën prej 140 euro
-Për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 250 euro,
apo gjithsejtë shumën prej 2,720.00 euro, ashtu që shumën e tërësishëm për të dy paditësit si në pikën I të dispozitivit prej **12,324.30 euro, DETYROHET** e paditura t'ia paguaj paditësve me kamatë ligjore sipas normës 8%, nga dita e nxjerrjes së ekspertizës mjekësore me datë 22.03.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 2,018.80 euro, e të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

II. KËRKESPADIA e paditësve e cila ka të bëjë për kompensimin në shumën më të lartë se sa shuma e gjykuar si nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për paditësin Fevzije H. në emër të dëmit jo material për dhimbjeve trupore fizike shumën 1,300.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 1,600.00 €, për shëmtimin trupor shumën prej 800 euro dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 6 % në shumën prej 2,800.00 euro ndërsa në emër të dëmit material për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 123.70 euro, si dhe për paditësin G. H. dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbjeve trupore fizike shumën 700 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 300 euro apo shuma e tërësishme prej 7,623.70 euro **REFUZOHET SI E PA BAZUAR.**

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë kanë paraqitur paditësit, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe ta aprovojë në tërësi kërkespadinë e precizuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankesë edhe pala e paditur, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitivave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë aneksën si të bazuar ta prish aktgjykimin e atakuar lidhur me pikën e I-rë dhe të II-të dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, F. H. dhe G. H., të dy nga fshati K., Komuna e G., përmes përfaqësuesit të autorizuar J. I., avokat nga P. me datë, 06.04.2018 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në P. për kompensimin e dëmit si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të datës 10.03.2018.

E paditura përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëve për nga lartësia e saj duke theksuar se është pa kontestueshme se me datë 10.03.2018 në ora 13:45 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit sipas përshkrimit të përfshirë në raportin e aksidentit të policisë së Kosovës dhe e njëjta ka shprehë gatishmërinë që mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjesisë ti zhdëmtoj paditësit në përputhje me dëmin që i është shkaktuar duke i dhënë ofertë paditësve në procedurë jashtë gjyqësore për të gjitha format e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.107/2018 të datës 21.04.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar nga aktgjykimin penal i formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogov P.nr.360/2018, P.nr.17/2019 të datës 16.03.2019, gjykata vërtetoi faktin se ngasësja e automjetit opel cambo M. J. është shpallur fajtores dhe është dënuar me dënim të kushtëzuar me burg në kohëzgjatje prej 10 muaj dhe në të njëjtën kohë ka urdhëruar që ky dënim mos të ekzekutohet nëse e njëjta në afat prej 2 vite nuk kryen vepër tjetër penale për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të përshkruar si më lartë, andaj baza juridike e kërkesëpadisë së paditëve është e vërtetuar po ashtu nuk është e kontestuar nga e paditura. Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësve, gjykata sipas propozimit të palëve ka nxjerrë ekspertizat mjekësore me ekspertët Dr. Vjollca Binçe - ortopend, Dr. Njazi Heta – ekspert maksillofacial dhe Dr. Valbona Blakaj – psikiatër, të cilët pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësve kanë dhënë mendimin e tyre profesional lidhur me natyrën, shkallën, pasojat e lëndimeve dhe frikën që kanë pësuar ata si pasojë e këtij aksidenti. Ekspertet e ortopedisë Dr. Vjollca Binçe dhe ai i lëmisë maksillofacial në ekspertizën e tyre lidhur me natyrën, shkallën, pasojat e lëndimit dhe intensitetin e dhimbjeve të paditëses F. H. të pësuar në aksidentin e lartcekur kanë theksuar se paditësja F. H. ka pësuar këto lëndime: hematoma për rreth dy orbitave të syrit, hematoma në regjionin e hundës dhe gojës, plagë shqyse në regjionin e gojës dhe hundës, hematomë në regjionin e gjurit dhe dy kërcinjëve, ndrydhje të regjionit të gjoksit dhe lumbuosakral, dalje nga vendi (luhatje e dhëmbëve 11,21,22,23 dhe frakturë e kurorës së dhëmbit 21) të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore për shkak të luhatjes së dhëmbëve dhe thyerjes së kurorës së dhëmbëve (dëmtime të dhëmbëve), si pasojë e të cilave lëndimeve paditësja ka pësuar dhimbje fizike posaqërisht të rëndë në kohëzgjatje rreth 20 minuta duke marrë parasysh vendodhjen e aksidentit e deri në ekzaminimet klinike dhe marrjen e anagjetikëve, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që ka zgjatur edhe për dy ditë deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur për 20 ditë të shprehura me dhimbje gjatë marrjes së ushqimit dhe vështirësi në marrje të ushqimit si pasojë e lëndimeve në regjionin e dhëmbëve në regjionin e nofullës për çka edhe i është nevojitur të bëhet nxjerrja e dhëmbëve dhe vendosja e kurorës, dhimbje fizike të intensitetit të ulët në kohëzgjatje që posedon akoma gjatë marrjes së ushqimit me të cilat ka probleme si dhe në ndërrime klimatike. Si pasojë e lëndimeve paditësja ka pësuar shëmtim trupor të shkallës së lehtë për çështje estetike të dhimbjeve të dhëmbëve ku dhëmbët natyral nuk mundë që të zëvendësohen me dhëmbët artificial të cilët nuk mund ta kryejnë

funksionin e dhëmbëve natyral, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 6 % duke u bazuar në kapitullin IV, sistemi tretës pika I, zgavër e gojës dhëmbët, ku kemi humbje të dhëmbëve mprehës të nofullës së sipërme të bazuar sipas tabelës së vlerësimit të BQK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të vitit 2016 ku humbja e së cilit dhëmbë ku humbja e një dhëmbi të përparmë mbrehës vlerësohet me 1.5%. Paditëses i është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javësh dhe atë i pasur me proteina, minerale dhe vitamina si dhe ushqim i lëngët për shkak të problemeve me dhëmb. I është nevojitur ndihma nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 7 ditësh për shkak të ndrydhjeve nëpër regjionin e trupit dhe vështirësisë në kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore. Rehabilitimi ka qenë i nevojshëm pas largimit të dhëmbëve një muaj për vendosjen e dhëmbëve të humbur ku ekzistojnë disa metoda (vendosja e dhëmbëve, mbjellja e dhëmbëve, apo vendosja e një ure në lidhje me dhëmbët e shëndosh ku paditësja ka zgjedh metodën e vendosjes së urës), për nofullën e sipërme. Ekspertja e psikiatrisë Dr. Valbona Blakaj, lidhur me frikën e përjetuar të paditëses si pasojë e aksidentit ka konstatuar se paditësja ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda, meqenëse sipas të dhënave nga e dëmtuara në momentin e fundit e ka dëgjuar zhurmën si dhe e ka vërejtur lëvizjen kautike të automatit të cili e ka shkaktuar aksidentin e cila frikë cilësohet si frikë nga përfundimi fatal, frikë sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjatur 48 orë si gjendje e stresit pas traumës e shfaqur me ankth të gjeneralizuar, shqetësim dhe frikë nga pasojat e këtij aksidenti për shkak të lëndimeve në shumë pjesë trupore si dhe moshës relativisht të re të sajë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 6 javë duke u përballur me trajtime dhe tretmane të shumta mjekësore, ku hynë edhe periudha e hospitalizimit, mbajtja e pozitës së detyruar për shkak të korsetit në regjionin e gjoksit dhe belit e po ashtu edhe imobilizimit me qafore në regjionin e qafës. E njëjta ka pasur vështirësi për tu ushqyer e po ashtu ka përjetuar dhimbje të herë pas hareshme trupore. Për shkak të problemeve me gjumë, rikujtimit të ngjarjes traumatike si dhe uljes së vullnetit dhe disponimit e ka kërkuar ndihmën e mjekut psikiatër me ç’ rast i është përshkruar edhe terapia medikamentoze adekuate. Frika sekondare e intensitetit të ulët vazhdon ende herë pas here sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, kur të njëjtës edhe i rikujtohet momenti i aksidentit me ç’ rast ndien shqetësim prej intensitetit të lehtë e po ashtu e përjeton ndjenjën e pasigurisë. Ekspertja e ortopedisë Dr. Vjollca Binçe në ekspertizën e saj lidhur me natyrën, shkallën, pasojat e lëndimit dhe intensitetin e dhimbjeve të pësuar të paditësit G. H. në aksidentin e komunikacionit ka dhënë mendimin e saj se paditësi ka pësuar këto lëndime: përdredhje të qafës, ndrydhje të krahut të djathtë, ndrydhje të shpinës, ndrydhje të gjoksit, ndrydhje të regjionit të dy gjunjëve, të cilat lëndime bëjnë pjesë si lëndime të lehta trupore si pasojë e të cilave paditësi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të rendë në kohëzgjatje prej 24 orëve, e shprehur me dhimbje në regjionet e ndrydhura, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur edhe për 18 ditë të shprehura kryesisht me dhimbje në regjionin e qafës për çka e ka mbajtur edhe qaforen e but por edhe dhimbje në regjionin e shpinës dhe të gjunjëve, dhimbje fizike të intensitetit të ulur që kanë zgjatur edhe për dy muaj kohë pas kohe në regjionet e ndrydhura. Paditësi nuk ka shëmtim trupore, nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, të njëjtit i është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditësh i pasur me proteina, mineral dhe vitamina, i është nevojitur ndihma nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 7 ditësh për shkak të vështirësive në kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore si pasojë e ndrydhjeve të shumëfishta në trup. I është nevojitur terapi fizikale në kohëzgjatje prej 10 ditësh e për të cilin ekziston edhe fletë lëshimi dhe atë terapi për forcimin e muskujve të regjionit të qafës, shpinës, gjoksit dhe gjunjëve.

Ekspertja e psikiatrisë Dr. Valbona Blakaj, lidhur me frikën e përjetuar të paditësit si pasojë e aksidentit ka konstatuar se paditësi ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda meqenëse i njëjti e ka perceptuar rrezikun e drejtpërdrejtë për jetën dhe është frikësuar për përfundim fatal, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 48 ore pas aksidentit me shqetësim, ankth dhe brengosje për pasojat shëndetësore të krijuara nga ky aksident, bazuar edhe në lëndimet e shumta trupore si dhe mënyrën se si ka ardhur deri te ky aksident, frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 4 javë duke u përballur me konsulta dhe tretmane mjekësore, mbajtjen e imobilizimit në qafë, përjetimin e herë pas hershëm të lëndimeve trupore, rikujtimin e ngjarjes traumatike, e po ashtu me brengosje dhe shqetësim për suksesin e trajtimit dhe shërbimit të tij për të çka edhe e ka kërkuar edhe ndihmën e mjekut psikiatër me ç’ rast i është përshkruar terapia kundër ankthit dhe elementit depresiv, frikë sekondare të intensitetit të ulët vazhdon ende, herë pas here sidomos në situatat kur merr pjesë në komunikacion kur edhe i rikujtohet momenti i aksidentit, duke e bërë që të ndjej parehati dhe pa siguri. Gjykata e aprovoj pjesërisht të bazuar kërkesapdinë e paditësve duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike si më lartë, me vlerësimin se e paditura mban përgjegjësi për dëmin që iu është shkaktuar, palës paditëse mbi bazën e përgjegjësisë, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, me nr. 04/L-018, e lidhur dispozitat e nenit 136.1, 140, 159.1, 169, 179 ,183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe nenit 323 të LPK-së. Për sa i përket kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e bazoi në nenin 449 dhe 452 të LPK-së. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë, ndërsa për dëmin material për shpenzimet e shërimit të paditëses F. H. në shumën prej 123.70 euro gjykata e ka refuzuar për shkak se paditësi nuk ka ofruar prova për ta vërtetuar këtë fakt, bazuar në nenin 7.1 dhe 319 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesët në të cilat aktgjykimi është vërtetuar nga kjo gjykatë e shkallës së dytë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë nga palët ndërgjyqëse, përveç pjesës së ndryshuar në pikën I-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi për të cilën gjykata e shkallës së dytë ka ardh në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe këto pjesë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të të paditurës rezultojnë të pa bazuara, ngase, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishtme të kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e

shkallës së parë lidhur me bazën e përgjegjësisë së të paditurës për kompensimin e dëmit, dhe lidhur me lartësinë e kompensimit për kategoritë të cilat janë vërtetuar, i pranon në tërësi Gjykata e Apelit duke i refuzuar pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë lidhur me vendimin e saj për lartësinë e kompensimit të dëmit nuk përmban arsyet për faktet të cilat kanë qenë vendimetare për marrjen e një vendimi të tillë, ngase baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar sipas aktgjykimit penal P.nr.360/2018, P.nr.17/2019 të datës 16.03.2019 konfirmimit 14 të LPK-së, ndërsa për sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë si pikë refernte për gjykatën ish-in, ekspertizat mjekësore të ekspertit të lëmisë macilofaciale të dhënë në seancën e datë 22.03.2021, ekspertizat e ekspertëve të ortopedisë Dr.Vjollca Binqe dhënë në seancën e datës 22.03.2021 dhe ekspertiza e ekspertes së psikiatrisë Dr. Valbona Blakaj dhënë në seancën kryesore të datës 22.03.2021 të cilët pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësve kanë dhënë mendimin e tyre profesional lidhur me natyrën, shkallën, pasojat e lëndimeve dhe frikën që kanë pësuar ata si pasojë e këtij aksidenti, rrjedhimisht, pretendimet ankimore të të paditurës në këtë kuptim nuk qëndrojnë dhe si të tilla refuzohen si të pa bazuara.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të paditëses F. H., sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e përjetuara fizike dhe për frikën e përjetuar. Gjykata, në vend të shumës së gjykuar prej 2.700,00 euro në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike për paditësen F. H., duke vlerësuar se kjo shumë është e ultë dhe në disproporcion me pasojat e dëmit jo material dhe duke marrë për bazë standardin e praktikës gjyqësore të krijuar për këtë kategori të dëmit jo material, vlerësoi se kjo kategori duhet ndryshuar ashtu që për dhimbjet fizike të përjetuara për paditësen Fevzije H. e gjykoi shumën prej 4.000,00 euro. Tutje, në emër të frikës së përjetuar, në vend të shumës së gjykuar prej 1.900,00 euro, duke vlerësuar se kjo shumë është e ultë dhe në disproporcion me pasojat e dëmit jo material dhe duke marrë për bazë standardin e praktikës gjyqësore të krijuar për këtë kategori të dëmit jo material, vlerësoi se kjo kategori duhet ndryshuar dhe gjykoi shumën prej 3.000,00 euro.

Gjykata e Apelit vlerëson se tani shumat e gjykuara për paditësen F. H. si në dispozitivin I-rë të këtij aktgjykimi janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 paragrafi 2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që të dëmtuarën (në këtë rast paditësen F. H.) ti përballojë më lehtë dëmet jo materiale dhe materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 183 paragrafi 2 të LMD-së përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit (në rastin konkret paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore) ashtu që kompensimi për dhimbjet fizike të pësuar, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor i cili në rastin e paditëses nga ekspertiza mjekësore u vlerësua të jetë në shkallë prej 6%, duhet të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, e në të njëjtën kohë

ato duhet të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Po ashtu shumat e gjykuara për paditësin janë në harmoni me udhëzuesin nr 41/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material të datës 27.02.2023 të cilat kriterë mundësojnë zbatimin uniform të nenit 183, 184, dhe 185, të Ligjit 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e paditësve për sa i përket kërkesës për kompensimin e dëmit sikurse shumat e precizuara në kërkespadi si të pathemeltë, pasi që shumat e gjykuara me këtë Aktgjykim për këto kategori të dëmit jo material janë në harmoni me lëndimet e paditësve dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e dëmit material për ushqim të përforcuar, për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, për shpenzimet e shërimit se paditësit me këtë rast kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë. Forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e gjykatave të Kosovës, i njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to, përkatësisht për kategorin e dëmit material në emër të kujdesit të huaj dhe ushqimit të përforcuar. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar, për periudhën e cekur në ekspertizë, atëherë shumat e gjykuara në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë janë proporcionale me dëmin e shkaktuar për këto kategori, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar. Po ashtu, edhe shpenzimet e mjekimit janë vërtetuar me këtë aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, e cila konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë edhe lidhur me vendosjen lidhur me kamatën vjetore prej 8 % nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së i cili shprehimisht përcakton “Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4015/2021 me datë 20.05.2024

Numri i lëndës: 2019:173513
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05751713

**Kryetari i Kolegjit,
Besnik Feka**